

# Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje

**Shqyrtimi i rasteve dhe rruga drejt  
bashkëpunimit institucional**



Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

---

# **Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje**

**Shqyrtimi i rasteve dhe rruga drejt  
bashkëpunimit institucional**

Prishtinë, korrik 2015

---

E drejta e autorit © 2015. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe kontrollimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret serish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet, incizohet apo tjera, pa lejen paraprake të D4D-së.

Punimi i përgatitur nga:

Dardan Berisha

Me kontribute nga:

Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Rina Vokshi

Redaktuar nga:

Leon Malazogu

Ky raport është publikuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) si pjesë e projektit për Drejtësi në Zgjedhje që përkrahet nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme (FDFA) të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është në tërësi përgjegjësi e Institutit D4D.

---

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	7
1. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	10
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	21
3. Prokuroria Shtetërore	25
4. Policia e Kosovës	28
5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës	30
6. Komisioni i Pavarur për Media	34
Udhëzues për bashkëpunim institucional	37

---

## Përmbledhje ekzekutive

Ky raport analizon vendosjen e drejtësisë në zgjedhjet e fundit, dhe ka për qëllim të shërbej si udhërrëfyes për koordinim të përhershëm institucional në zgjidhjen e kontesteve që ndërlidhen me zgjedhjet. Gjashtë pjesët tematike të këtij raporti mbulojnë të dhëna mbi: vendimet për shkeljet administrative zgjedhore, mbikëqyrjen e financave të subjekteve politike, hetimet dhe zgjedhjet e kallëzimeve penale që ndërlidhen me zgjedhjet, si dhe veprimet e ndërmarra për ankesat ndaj mediave.

Sa i përket shkeljeve administrative, në zgjedhjet lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, janë dorëzuar 550, respektivisht 492 ankesa në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 numri i ankesave është dyfishuar në 1.109, ndërkohë që të zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 është shënuar rënie në 341 ankesa të regjistruara. Gjohat e PZAP për subjektet politike kanë arritur shifrën më të lartë në zgjedhjet e vitit 2010, me një vlerë të përgjithshme prej 377.450 Euro.

Sa i përket financimit të subjekteve politike, për shkak të vonesave në dorëzimin e raporteve financiare për zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka gjobitur 22 subjekte politike relativisht të vogla. Si pasojë e parregullsive dhe manipulimeve të procesit zgjedhor dhe mospërputhshmërisë së rezultateve, në periudhën prej 2009 deri 2014, KQZ urdhëroi disa herë përsëritjen e zgjedhjeve.

Për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, KQZ referoi në Prokurorinë Shtetërore 239 lëndë të dyshimta. Megjithatë, duket se ky numër nuk përputhet me numrin e lëndëve të cilat Prokuroria Shtetërore konfirmon se ka pranuar. Gjatë viteve 2013 dhe 2014, Prokuroria Shtetërore trajtoi 378 kallëzime penale që ndërlidhen me zgjedhjet, e që përfshinin 1.450

---

persona. Prokuroritë themelore në Pejë, Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj kanë qenë më efikase në zgjidhjen e kallëzimeve penale për shkelje në zgjedhje, në krahasim me ato të Mitrovicës dhe Prishtinës.

Policia e Kosovës ka administruar 113 lëndë të shkeljeve zgjedhore gjatë zgjedhjeve të vitit 2013 dhe 2014, shumicën e të cilave i ka hetuar në bashkëpunim me PSH. Një numër i konsiderueshëm i personave ishin arrestuar nga policia në ditën e zgjedhjeve, 37 në 2013, dhe 18 në zgjedhjet e vitit 2014.

Në rastet kur ka pasur dëshmi të mjaftueshme kundër personave që kanë kryer vepra penale gjatë zgjedhjeve, Prokuroria e Shtetit ka ngritur aktakuzë në Gjykatat Themelore. Gjatë vitit 2014, gjykatat kanë pasur 281 lëndë të ndërlidhura me veprat penale të zgjedhjeve, e që përfshinin 1.171 persona. Gjatë vitit 2014 gjykatat kanë zgjidhur 128 lëndë, nga të cilat në 101 lëndë kanë rezultuar me aktgjykim fajësues. Megjithatë, për veprat penale që ndërlidhen me zgjedhjet vetëm 10 persona janë dënuar me burg, dhe shumica e tyre janë liruar me kusht.

Sa i përket shkeljeve nga ana e mediave në zgjedhjet e mbajtura në periudhën 2009-2014, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka trajtuar 225 ankesa. Tri të katërtat (75%) e ankesave kundër mediave transmetuesve kanë pasur të bëjnë me dështimin e tyre për të dorëzuar në KPM ditarin e veçantë kohës që është ofruar për subjektet politike.

Në përgjithësi, numri i kontesteve gjatë proceseve të fundit zgjedhore ka qenë i madh. Përderisa në vitin 2009 dhe 2010, kjo ka mundur të shihet si tregues i zgjedhjeve të pa-rregullta, në zgjedhjet 2013 dhe 2014 kjo duhet parë si dëshmi e gatishmërisë dhe vullnetit të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve dhe institucioneve të gjyqësorit për të adresuar ankesat e partive politike, vëzhguesve dhe votuesve.

---

Meqenëse zgjidhja e kontesteve është proces i ndërvarur, do të ishte e dobishme nëse institucionet përgjegjëse për menaxhimin zgjedhjeve dhe autoritetet gjyqësore vazhdojnë të ndërtojnë mbi të arriturat e tyre, dhe forcojnë zingjirin institucional duke koordinuar aktivitetet e tyre në të gjitha fazat e ciklit zgjedhor.

---

## Hyrje

Qëllimi i përgjithshëm i këtij raporti është të përmirësoj koordinimin në mes të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve dhe autoriteteve gjyqësore, duke shpalosur të dhëna ndërinstytucionale nga zgjedhjet e kaluara, dhe duke identifikuar masat që këto institucione mund të ndërmarrin për të avancuar koordinimin në të gjitha fazat e ciklit zgjedhor. Raporti është zhvilluar në kuadër të Projektit për Drejtësi në Zgjedhje, që financohet nga Departamenti Federal për Punë të Jashtme (FDFA) të Zvicrës.

Raporti mbulon të dhënat mbi: dënimet e shqiptuara për shkeljet administrative që ndërlidhen me zgjedhjet, mbikëqyrjen e financave të subjekteve politike, hetimin dhe zgjidhjen e kallëzimeve penale, si dhe veprimet e ndërmarra për ankesat ndaj mediave. Në rastet kur ka pasur informata të detajuara, të dhënat janë ndarë sipas natyrës së shkeljes gjatë procesit zgjedhor, llojin e aktgjykimit dhe komunën apo rajonin ku kanë ndodhur shkeljet e supozuara. Për të përgatitur këtë raport D4D ka mbledhur të dhëna të papërpunuara nga: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Prokuroria Shtetërore (PSH), Policia e Kosovës (PK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM). Në vijim të këtij raporti, të dhënat nga këto institucione prezantohen në kapituj të veçantë.

Radhitja e kapitujve ndjek rrjedhën kronologjike të procedimit të lëndëve të zgjedhjeve, nga momenti kur kontestet dorëzohen, deri në momentin kur ato zgjidhen. Si hap i parë, pakënaqësitë e palëve gjatë procesit zgjedhor dorëzohen në PZAP, si instanca e parë përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave zgjedhore. Si hap i dytë, KQZ si institucioni primar përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve mund të referojë rastet e dyshimta për parregullsi



---

gjatë zgjedhjeve për shqyrtim të mëtutjeshëm në PSH. Si hap i tretë, PSH ka përgjegjësi për të bërë ndjekjen penale dhe hetimet para se të ngris aktakuzë në Gjykatën Themelore. Si hap i katërt, në mënyrë që të mbliidhen prova dhe të përfundohen hetimet PSH mund të kërkoj ndihmë nga PK që është përgjegjëse për të ofruar ndihmën e nevojshme. Si hap i pestë, nëse ka prova të mjaftueshme se janë shkelur të drejtat e votimit, ngritet aktakuzë dhe lëndët që kanë të bëjnë zgjedhjet trajtohen në një nga Gjykatat Themelore të vendit, ku gjyqtarët shpallin aktgjykimet. Si hap i gjashtë, është me rëndësi të shikohen ankesat që ndërliidhen me shkeljet e pretenduara nga ana e mediave, e që trajtohen nga KPM. Të dhënat për apelet ndaj vendimeve të PZAP në Gjykatën Supreme janë përfshirë në kuadër të kapitullit për PZAP.

Raporti përfshinë edhe skemën e trajtimit të kontesteve zgjedhore gjatë vitit 2014, meqenëse vetëm për këtë vit të gjitha të dhënat kanë qenë të disponueshme. Skema e trajtimit të lëndëve e bënë më të lehtë vizualizimin e procesit të drejtësisë në zgjedhje, ngase deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre, lëndët mund të qarkullojnë nga njëri institucion në tjetrin. Skema e trajtimit të lëndëve nganjëherë tregon mospërputhje (≠) në kuptimin statistikor, apo mungesë të të dhënave. Kjo skemë është paraqitur në një faqe shtesë të veçantë të këtij publikimi, dhe mund të gjindet edhe në versionin elektronik.

Raporti përfundon me rekomandime të shtruar në formë të listës së veprimeve të mundshme që secili institucion mund të ndërmarrë, përgjatë fazave të ndryshme të ciklit zgjedhor, me qëllim të forcimit të zingjirit institucional. Këto rekomandime përfshijnë kontributin e akterëve të ndryshëm, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve, gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët e policisë dhe ekspertët e zgjedhjeve nga radhët e shoqërisë civile.

---

Përgatitja e këtij raporti nuk do të ishte e mundur pa bashkëpunimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë Shtetërore, Policinë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe Komisionit të Pavarur të Mediave. Me kërkesën tonë këto institucione kanë ofruar qasjen në të dhënat e disponueshme me kohë, dhe vazhdimisht kanë qenë të hapur për konsultime dhe sqarime.


---

## 1. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) shërben si organ i shkallës së parë, përgjegjës për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Të vetmet lëndë që kanë të bëjnë me zgjedhjet e të cilat PZAP i referon te institucionet tjera, janë ato që kanë të bëjnë me vepra penale (Prokuroria Shtetëtare) dhe shkeljet nga ana e medieve (Komisioni i Pavarur i Mediave).

Numri i ankesave dhe parashtresave ka mbetur pothuajse në nivelin e njëjtë në zgjedhjet lokale të vitit 2009 dhe ato të përgjithshme të vitit 2010, ndërsa është dyfishuar në zgjedhjet lokale të vitit 2013, dhe pastaj ka shënuar rënie në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 (Figura 1).

*Figura 1: Numri i ankesave dhe apeleve në zgjedhje, prej 2009 deri 2014*



Është e kuptueshme që gara në nivel lokal shkakton më shumë konteste, duke marrë parasysh që në krahasim me zgjedhjet e përgjithshme, ka më shumë subjekte politike dhe kandidatë. Numri i ankesave ka arritur kulminacionin në vitin 2013, me gjithë faktin që opinioni i gjerë konsideron që këto zgjedhje kanë qenë më të mira se ato të viteve më parë.

---

Numri i madh i ankesave të dorëzuara në vitin 2013 mund të shpjegohet edhe më faktin se fushata e PZAP për informimin publik ka qenë më intensive. Gjithashtu, organizatat e shoqërisë civile kanë inkurajuar votuesit dhe partitë që të ankohen, madje edhe duke i informuar për procedurat e ankimit. Numri i ankesave të regjistruara në zgjedhjet e vitit 2014 ishte tri herë më i vogël. Rënia e numrit të ankesave në vitin 2014 erdhi si rezultat i respektimit më të madh të ligjeve dhe rregulloreve nga ana e subjekteve politike, forcimi i besimit të publikut në procesin zgjedhor dhe përmirësimi i administrimit të zgjedhjeve.

Vija e kuqe (figura 1) tregon trendin e apeleve ndaj vendimeve të KQZ. Numri relativisht i vogël i apeleve në zgjedhjet e periudhës 2009-2014 tregon që vendimet e KQZ kanë qenë kryesisht të drejta dhe rrallë janë kontestuar nga subjektet politike apo votuesit. Figura e mësipërme nuk përfshin apelet e dorëzuara nga votuesit jashtë vendit, ndaj vendimit të KQZ për refuzim të aplikacioneve të tyre për të votuar nga jashtë vendit. Të dhënat përfshijnë vetëm apelet ndaj vendimeve të KQZ që: a) refuzojnë të certifikojnë subjektet politike apo listat e kandidatëve; b) refuzojnë të akreditojnë vëzhguesit; c) refuzojnë të regjistrojnë partinë; d) vendosin gjoba administrative në lidhje me deklarimin e financave; apo e) ankesat tjera që ndërlidhen me procedurat e KQZ për zgjedhjet.


Ankesat janë dorëzuar në PZAP në faza të ndryshme të procesit zgjedhor, ndërkohë që të dhënat janë ndarë vetëm për zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014, për të cilat të gjitha të dhënat kanë qenë të disponueshme (Figura 2). Ankesat e parashtruara në zgjedhjet e viti 2013 kanë qenë të ndara pothuajse njëjtë në të gjitha fazat: fushata dhe dita e zgjedhjeve (secila nga 23%), rezultatet preliminare (22%) dhe rezultati përfundimtar (25%).

Përderisa numri i vogël i ankesave në zgjedhjet e vitit 2014 ka paraqitur trend pozitiv, klima e polarizuar politike ka ndikuar

---

që fushata të jetë më e tensionuar. Në zgjedhjet e vitit 2014, ka pasur rritje të konsiderueshme të numrit të ankesave gjatë fushatës, të cilat përbënin gati gjysmën (47%) e ankesave të dorëzuara në këtë periudhë.


Figura 2: Numri i ankesave dhe apeleve gjatë zgjedhjeve 2013 dhe 2014, sipas fazave të procesit zgjedhor



---

PZAP mund të shqiptojë gjoba për subjektet politike, nëse konstaton se kanë bërë ndonjë shkelje në procesin zgjedhor. Vlera e përgjithshme e gjobave të shqiptuara nga PZAP është dyfishuar nga viti 2009 në vitin 2010. Në këto zgjedhje vëzhguesit kanë raportuar parregullsi në shkallë të gjerë, që kryesisht janë kryer nga subjektet politike në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Numri i madh i gjobave të shqiptuara gjatë vitit 2010 u tregua faktor parandalues për zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014, meqenëse numri i gjobave shënoi rënie (Figura 3).

*Figura 3: Total gjoba të shqiptuara nga PZAP për subjektet politike në zgjedhje, prej 2009 deri 2014*




Më pas, vlera e përgjithshme e gjobave të shqiptuara nga PZAP është ndarë sipas subjekteve politike (Figura 4). Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) i janë shqiptuar më së shumti gjoba për periudhën që është analizuar, me 39% të vlerës së përgjithshme të gjobave në vitin 2010, dhe 64% të gjobave në vitin 2014. Në vendin e dytë qëndron Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 23% të vlerës së përgjithshme të gjobave në vitin 2009 dhe 2010, e që gradualisht ka rënë në 14% në vitin 2014.

*Figura 4: Gjjobat e shqiptuara nga PZAP prej 2009 deri 2014, sipas subjekteve politike*

	2009	2010	2013	2014
<b>PDK</b>	€ 85.620	€ 148.400	€ 93.150	€ 55.900
<b>LDK</b>	€ 48.900	€ 88.050	€ 38.100	€ 12.200
<b>AAK</b>	€ 12.720	€ 77.600	€ 36.300	€ 3.900
<b>VV</b>	n/a	€ 6.250	€ 1.750	€ 3.500
<b>AKR</b>	€ 21.600	€ 38.850	€ 11.900	€ -
<b>Tjera</b>	€ 41.330	€ 18.300	€ 9.350	€ 11.200
<b>Total</b>	<b>€ 210.170</b>	<b>€ 377.450</b>	<b>€ 190.550</b>	<b>€ 86.700</b>

Aleanca per Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) qëndrojnë në vendin e tretë dhe të katërt sa i përket përqindjes së vlerës së gjjobave. Në mesin e subjekteve kryesore, Vetëvendosja (VV) ka pasur përqindjen më të ulët të vlerës së gjjobave, duke qëndruar vazhdimisht nën 5% (Figura 5).

*Figura 5: Trendet e gjjobave të PZAP për subjektet politike në zgjedhjet e periudhës 2009-2014*





---


Për lexuesit që janë më kërkues, në vijim janë përmbledhur numri i ankesave sipas komunave ku kanë ndodhur shkeljet e pretenduara, të grumbulluara rreth shtatë qyteteve kryesore (Figura 6). Natyrisht, komunat më të mëdha prijnë me numrin më të madh të ankesave, meqenëse aty ka më shumë organizime gjatë fushatës, më shumë vendvotime dhe më shumë votues. Megjithatë, janë disa komuna të vogla të cilat befasojnë duke qëndruar lartë në këtë listë. Për shembull Lipjani dhe Vushtrria kanë nga 5% të numrit të përgjithshëm të ankesave. Nga viti 2009 deri në vitin 2014, ka pasur rritje të numrit të ankesave të dorëzuara për komunat veriore. Numri i përgjithshëm i ankesave i prezantuar në figurën 1 nuk përputhet me numrin e ankesave sipas komunave, por të dhënat kanë qenë kështu edhe në versionet burimore të cilat i ka siguruar D4D.

*Figura 6: Ankesat sipas komunave dhe rajoneve ku pretendohet se kanë ndodhur shkelja, prej 2009 deri 2014*

	2009	2010	2013	2014		2009	2010	2013	2014
<b>Prishtinë</b>	<b>177</b>	<b>215</b>	<b>322</b>	<b>152</b>	<b>Gjilan</b>	<b>89</b>	<b>20</b>	<b>136</b>	<b>14</b>
Prishtinë	64	164	109	120	Gjilan	54	18	30	6
Lipjan	48	7	78	1	Kamenicë	10	0	53	5
Obiliq	5	2	46	1	Viti	11	2	35	2
Podujevë	21	6	31	24	Novobërdë	0	0	11	0
F. Kosovë	14	5	28	1	Kllkot	0	0	1	1
Drenas	2	26	11	0	Partesh	14	0	4	0
Graçanicë	23	5	19	5	Ranillugë	0	0	2	0
<b>Pejë</b>	<b>35</b>	<b>27</b>	<b>172</b>	<b>17</b>	<b>Gjakovë</b>	<b>66</b>	<b>29</b>	<b>92</b>	<b>31</b>
Pejë	16	12	40	8	Gjakovë	26	8	36	3
Istog	12	4	57	5	Rahovec	15	2	16	8
Klinë	7	11	45	1	Malishevë	25	19	36	20
Deçan	0	0	30	3	Junik	0	0	4	0
<b>Mitrovicë</b>	<b>35</b>	<b>94</b>	<b>148</b>	<b>22</b>	<b>Prizren</b>	<b>91</b>	<b>36</b>	<b>106</b>	<b>62</b>
Mitrovicë	7	32	36	10	Prizren	58	28	81	48
Skenderaj	19	49	2	3	Suharekë	31	3	17	11
Vushtrri	9	12	101	2	Mamushë	0	0	6	3
Mitrovica V.	0	0	4	3	Dragash	2	5	2	0
Z.Potok	0	0	1	0	<b>Ferizaj</b>	<b>60</b>	<b>35</b>	<b>134</b>	<b>41</b>
Leposaviç	0	1	2	3	Ferizaj	21	17	107	37
Zveçan	0	0	2	1	Shtime	12	0	12	1
					Kaçanik	15	12	8	3
					Hani i Elezit	4	0	5	0
					Shtërpçë	8	6	2	0

Gjithashtu, është me rëndësi të shikohet se çfarë ka ndodhur me ankesat pasi që janë trajtuar nga PZAP. Numri më i madh i ankesave është refuzuar nga PZAP, në mungesë të bazës ligjore, si p.sh ankesat nuk kanë pasur ndonjë dëshmi se shkelja e pretenduar ka ndodhur, apo i ka munguar arsyetimi. Në vitin 2009, shumica e ankesave janë refuzuar apo nuk janë shqyrtuar fare (79%) (Figura 7). Në vitet që pasuan, PZAP filloi të përdor një kategorizim më të detajuar të vendimeve. Shkalla e pranueshmërisë (lëndët për të cilat PZAP ka vlerësuar se shkelja e pretenduar ka ndodhur) ka arritur kulminacionin në vitin 2010 (32%), ndërsa ka rënë në nivelin më të ulët në vitin 2013 (12%).

*Figura 7: Numri i vendimeve të PZAP sipas llojeve të vendimeve, prej 2009 deri 2014*



Një numër i konsiderueshëm i ankesave nuk është shqyrtuar fare nga paneli shqyrtues i PZAP, dhe kjo mund të ketë ndodhur për shumë arsye procedurale si: a) ankesa nuk ka qenë brenda kompetencave të PZAP; b) ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit ligjor; apo c) ankesa nuk ka përmbushur kriteret kryesore. Në vitin 2010, shumica e ankesave që nuk janë shqyrtuar (72 %), janë konsideruar si

---

“të palejueshme” apo në kategorinë që konsiderohet jashtë mandatit ligjor të PZAP. Në vitin 2010 çdo e pesta ankesë është dorëzuar jashtë afatit të caktuar. Në vitin 2013, prej ankesave që nuk janë konsideruar, ankesat e “pa lejueshme” përbënin një përqindje të lartë (74%), por sidoqoftë një pjesë (18%) e ankesave janë tërhequr nga parashtruesit.

Në çdo palë zgjedhje mesatarisht 5% e vendimeve të PZAP janë apeluar në Gjykatën Supreme (108 ankesa nga viti 2009 deri në vitin 2014). Në shumicën e rasteve Gjykata Supreme ka përkrahur vendimet e PZAP, ndërsa vetëm në 4 raste nga 108 ka vendosur në favor të palëve që kanë sfiduar vendimet e PZAP.

Gjatë zgjedhjeve të vitit 2013 dhe 2014, PZAP është përballur me një numër të konsiderueshëm të apeleve kundër vendimeve të KQZ për të refuzuar aplikacionet e votuesve jashtë vendit, 16.410 në vitin 2013 dhe 9.171 në vitin 2014. Këto apele janë dorëzuar kryesisht nga votues Serb të cilët aplikuan për të votuar nga jashtë vendit. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2013, 5.458 (apo 33%) apele janë miratuar nga PZAP dhe si rezultat KQZ përfshiu emrat e tyre në listën përfundimtare të votuesve. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2014 vetëm 206 (2%) e apeleve janë miratuar.

Pjesa dërmuese e ankesave (nga viti 2009 deri në vitin 2014) janë dorëzuar nga subjektet politike. Prej tyre pjesa më e madhe janë dorëzuar nga kandidatët e partive, e që është tregues se gara është e drejtuar nga individë që duan të zgjedhen, por që gjithashtu tregon mundësi të manipulimeve të votave brenda subjekteve politike. Gati gjysma, apo 47% e ankesave gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013 janë dorëzuar nga kandidatët, për dallim nga 19% në zgjedhjet e vitit 2014. (Figura 8). Numri i madh i ankesave nga kandidatët pjesërisht shpjegohet edhe me faktin se numri i përgjithshëm i kandidatëve që garojnë në zgjedhjet lokale është i madh (mbi 7.000). PZAP ka grupuar të gjitha ankesat e kandidatëve në një vend, dhe nuk ka të dhëna se cilave parti ju përkasin.

*Figura 8: Numri i ankesave dhe apeleve në zgjedhjet prej 2009 deri 2014, sipas subjekteve që kanë parashtruar ankesat*

<b>Entiteti</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>
PDK	113	47	128	66
LDK	0	30	87	14
VV		177	157	124
AAK	30	15	41	2
NISMA			0	7
AKR	82	58	19	17
Kandidatët e subjekteve	0	0	525	64
Lista Sërbe			9	3
BIRN	0	39	27	2
Votuesit	59	50	9	7
Tjerë	266	76	107	35
<b>TOTAL</b>	<b>550</b>	<b>492</b>	<b>1.109</b>	<b>341</b>

Subjekti i tretë më i madh politik, Vetëvendosja, ka dorëzuar numrin më të madh të ankesave, e pasuar nga PDK, AKR dhe LDK. Organizatat e shoqërisë civile nuk kanë qenë shumë aktive në dorëzimin e ankesave, me përjashtim të BIRN të cilët për të gjitha proceset zgjedhore dorëzuan 68 ankesa.

Siq mund të shihet, gjatë proceseve zgjedhore të deri tashme PZAP ka trajtuar një numër relativisht të madh të ankesave dhe apeleve. Gjobat e shqiptuara nga PZAP për subjektet politike në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2010 kanë ndikuar që partitë të respektojnë më shumë ligjet dhe rregulloret në zgjedhjet që kanë pasuar. Për më tepër, PZAP është përballur me sfida të mëdha gjatë trajtimit të ankesave nga votuesit jashtë vendit, duke marrë parasysh që procedimi i tyre është dashur të bëhet brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore.

---

## 2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Edhe pse nuk ka mandat për të gjykuar kontestet zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në kuadër të kompetencave të tij, mund të luaj rol të rëndësishëm në vendosjen e drejtësisë në zgjedhje. Fillimisht, nëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dyshon që administruesit e zgjedhjeve kanë kryer vepra penale gjatë zgjedhjeve, mund ti referoj ata në Prokurorinë Shtetërore. KQZ mund të ofroj resurse dhe materiale të nevojshme për zgjidhjen e këtyre lëndëve. Përveç kësaj, KQZ mbikëqyr financat e subjekteve politike, dhe mund të shqiptoj gjopa për subjektet politike në rastet kur ato nuk respektojnë kërkesat për raportim të rregullt në baza vjetore apo kërkesat që kanë të bëjnë me financimin e fushatave. Gjithashtu, në rastet kur konstatohet se ka pasur parregullsi, KQZ mund të vendos për përsëritjen e plotë apo të pjesshme të zgjedhjeve, gjë që ka ndodhur disa herë gjatë zgjedhjeve të kaluara.

Sa i përket veprave penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka referuar 143 raste në Prokurorinë e Shtetit, për zgjedhjet lokale të vitit 2013 dhe 239 raste për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014. Natyra e këtyre rasteve të ngritura nga KQZ zakonisht vjen si rezultat i mospërputhjeve në mes formularëve të rezultateve dhe formularëve për kandidatët. Mospërputhshmëritë brenda dhe ndërmjet këtyre formularëve mund të shtyjnë KQZ të besoj se ka pasur manipulime, andaj këto raste referohen në Prokurorinë e Shtetit për shqyrtim dhe hetim të mëtutjeshëm. Prokuroria e Shtetit duket se nuk i regjistron lëndët e pranuar nga KQZ si vepra penale të reja, prandaj siç mund të shihet nga skema, ekziston mospërputhje (≠) në numrin e lëndëve të raportuara nga Prokuroria e Shtetit.

Sa i përket financave të subjekteve politike, për zgjedhjet lokale të vitit 2013 KQZ ka gjobitur dhjetë subjekte politike për vonesë në dorëzimin e raporteve financiare të fushatës

zgjedhore. Shumica e këtyre subjekteve (me përjashtim të njëjës) nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, dhe nuk kanë qasje në financat publike që ju ndahen subjekteve të përfaqësuara, e që nënkupton se mund të mos kenë kapacitetet e nevojshme administrative për përgatitjen e raporteve financiare. Vetëm dy subjekte politike, Partia e Ashkalinjeve për Integrim dhe Kosova Turk Adalet Partisi, kanë paguar gjrobat (Figura 9).

*Figura 9: Gjrobat e KQZ për subjektet që kanë vonuar dorëzimin e raporteve financiare të fushatës në zgjedhjet lokale 2013*

Subjekti Politik	Vonesa	Gjoba
Partia e Ashkalinjeve për Integrim	47 ditë	€ 3.516
Kosova Turk Adalet Partisi	34 ditë	€ 1.003
Crnogorska Liberalna Stranka	32 ditë	€ 1.002
Inicijativa za Bolji Život	81 ditë	€ 1.008
Zajedno za Lipljan	81 ditë	€ 1.008
Hysni Rexhepi	81 ditë	€ 1.008
Demokratska Inicijativa	78 ditë	€ 1.008
Narodna Pravda	77 ditë	€ 1.008
Partia Socialdemokrate	71 ditë	€ 1.007
Ylli Isufi	84 ditë	€ 1.008
<b>TOTAL</b>		<b>€ 12.578</b>

Në zgjedhjet e vitit 2014 nuk ka pasur vonesa në dorëzimin e raporteve financiare për fushatën zgjedhore. Këto ishin zgjedhje të përgjithshme, andaj numri i subjekteve politike që garuan në zgjedhje ka qenë më i vogël, dhe shumica e tyre ishin subjekte të mëdha. Shumica e subjekteve të mëdha duket se kanë respektuar afatet kohore për raportimin e financave të tyre, e që paraqet trend pozitiv për zgjedhjet.

Përveç rasteve lidhur me vonesat e raporteve financiare të fushatës, KQZ mund të shqiptojë gjoba edhe për vonesat në dorëzimin e raporteve financiare vjetore. Në vitin 2014, 12 subjekte politike që nuk arritën të përfaqësohen në Kuvendin e Kosovës u vonuan në dorëzimin e raporteve

---

financiare dhe të gjitha këto subjekte u gjobitën nga KQZ me nga 1.000 Euro.

Në periudhën 2009-2014, ka pasur raste ku janë përsëritur zgjedhjet në ndonjë komunë në të gjitha vendvotimet, mirëpo ka pasur raste edhe kur janë përsëritur në mënyrë të pjesshme, që do të thotë në një apo disa vendvotime të caktuara. Përsëritja e zgjedhjeve u urdhërua në bazë të vendimeve të PZAP, KQZ apo Gjykatës Supreme, për arsye të ndryshme si: mbushja e kutive në mënyrë të pa-rregulltë, vjedhja e votave, mospërputhja e rezultateve, dhuna apo presioni. Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009, u urdhërua përsëritja e plotë e zgjedhjeve në të gjitha qendrat e votimit në komunën e Lipjanit, Prizrenit dhe Gjilanit. Në vitin 2010 zgjedhjet u përsëritën në të gjitha qendrat e votimit në komunën e Deçanit, Skenderajt, Drenasit dhe Mitrovicës, dhe pjesërisht në nga një qendër të votimit në Malishevë dhe Lipjan. Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013, zgjedhjet u përsëritën në një qendër të votimit në Partesh, dy qendra të votimit në Zveçan dhe tri qendra të votimit në Mitrovicën e Veriut. Në zgjedhjet e vitit 2014 nuk ka pasur asnjë rast të përsëritjes së zgjedhjeve.

Në katër palë zgjedhjet e fundit, në shumë vendvotime kutitë e votimit ishin rinumëruar kryesisht për shkak të mospërputhjes së formularëve të rezultateve dhe pengesat e hasura në auditim të rezultateve. Numri i vendvotimeve të rinumëruara ka qëndruar në mes 420 deri në 450, me përjashtim të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010 ku 890 kuti të votimit iu nënshtruan procesit të rinumërimit (Figura 10).



-----

*Figura 10: Përsëritjet e zgjedhjeve dhe rinumërimi në zgjedhjet prej 2009 deri 2014*

<b>Përsëritjet/rinumërimet</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>
Nr.i komunave ku janë përsëritur zgjedhjet	3 komplet	4 komplet 2 pjesërisht	3 pjesërisht	Asnjë
Nr. i vendotimeve të rinumëruara	450	890	439	421

Si përfundim, KQZ duhet të përcjellë lëndët të cilat i referon në Prokurorinë Shtetërore në mënyrë që të sigurohet se lëndët janë shqyrtuar. KQZ duhet të ndihmoj prokurorët dhe gjyqtarët duke i informuar ata për procedurat e zgjedhjeve dhe duke u ofruar resurse dhe materiale që ndihmojnë zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

---

### 3. Prokuroria Shtetërore

Sa i përket drejtësisë në zgjedhje, Prokuroria Shtetërore (PSH) është përgjegjëse për ndjekjen penale të personave që kanë kryer veprat penale që ndërlidhen me zgjedhjet, siç përcaktohen në nenet 210-220 të Kodit Penal të Kosovës. PSH mund të inicioj ndjekjen penale në mënyrë të pavarur, mirëpo kallëzimet penale mund të ngritën edhe nga individët, subjektet politike dhe institucionet tjera.

Në vitin 2013 më shumë se gjysma apo 52% e kallëzimeve penale janë inicuar nga inspektoratet, ndërsa në vitin 2014 numri më i madh i tyre, apo 56% janë inicuar nga Policia e Kosovës (Figura 11). Përveç kësaj liste, KQZ thekson që për zgjedhjet e vitit 2014 ka dorëzuar 239 lëndë që ndërlidhen me zgjedhjet në PSH, ndërkohë që PZAP pretendon që ka dorëzuar edhe 34 lëndë të tilla, duke shtuar në numrin e lëndëve të pranuar. Këto lëndë nuk figurojnë si kallëzime penale të reja të pranuar nga Prokuroria Shtetërore, megjithëse disa prej tyre mund të jenë përfshirë në kategorinë “tjerë”.

*Figura 11: Numri i kallëzimeve penale të dorëzuara në vitin 2013 dhe 2014, sipas parashtruesve*

	2013	2014
Qytetarët	0	2
Policia e Kosovës	30	95
Agjencia Kundër-Korrupsion	0	1
Inspektorati	62	44
EULEX	0	0
Tjerë	27	27
<b>TOTAL</b>	<b>119</b>	<b>169</b>

Gjatë vitit 2013, Prokuroria Shtetërore ka trajtuar 209 kallëzime penale, nga të cilat më pak se gjysma (43%) kanë qenë të trashëguara nga vitet paraprake, ndërkohë që të tjerat

kanë qenë kallëzime penale të reja. Prokuroria e Shtetit ka zgjidhur afërsisht gjysmën e lëndëve, ndërkohë që 105 lëndë janë bartur në vitin 2014. Në vitin 2014, janë pranuar 169 kallëzime penale të reja, ndërkohë që janë zgjidhur vetëm 75

prej tyre. Në këtë mënyrë numri i kallëzimeve penale të mbetura ishte rritur nga 90 në janar të vitit 2013 në 199 të cilat duhet zgjidhur në vitin 2015 (Figura 12).

*Figura 12: Pasqyra vjetore e kallëzimeve penale në Prokurorinë e Shtetit për vitet 2013 dhe 2014*

Prokuroria Shtetërore 2013 dhe 2014 (Kallëzimet Penale)	2013		2014	
	Lëndë	Persona	Lëndë	Persona
Të mbetura nga viti paraprak	90	562	105	639
Të reja	119	654	169	244
<b>Total kallëzime penale</b>	<b>209</b>	<b>1.216</b>	<b>274</b>	<b>883</b>
Të zgjidhura	104	577	75	229
Të mbetura	105	639	199	654

Në tërësi, gjatë këtyre dy viteve u ngritën 378 kallëzime penale që përfshinin 1,460 persona. Fatkeqësisht, numri i lëndëve të mbetura është rritur, gjë që kërkon resurse shtesë për tu trajtuar në të ardhmen.

Më pas të gjitha kallëzimet penale ndahen sipas Prokurorive Themelore të Kosovës. Gjatë vitit 2013, pothuajse dy të tretat e kallëzimeve penale, apo 60%, kanë qenë në shqyrtim në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, ndërkohë që në vitin 2014 kishte rënie në 39%.

Prokuroria Themelore në Prizren ka qenë më e suksesshme në dy vitet, me 56% të kallëzimeve penale të zgjidhura në vitin 2013, dhe 89% të zgjidhura në vitin 2014. Peja e tejkalon Prizrenin në përqindje, por numri i lëndëve ka qenë dukshëm më i vogël. Prokuroria Themelore në Prishtinë ka qenë shumë efikase në vitin 2013, duke zgjidhur 56% të lëndëve zgjedhore, por performanca kishte rëndë në 11% në vitin 2014. Performancën më të dobët duket ta ketë pasur Mitrovica, ku gjatë këtyre dy viteve janë zgjidhur vetëm 2 lëndë (me gjithë faktin se 87 lëndë kanë qenë në shqyrtim). Në figurën në vazhdim prezantohen detaje sa i përket lëndëve dhe personave të përfshirë për secilit vit (Figura 13).

Figura 13: Pasqyra vjetore e lëndëve dhe personave të përfshirë në Prokurorinë e Shtetit për vitet 2013 dhe 2014, sipas Prokurorive Themelore

Gjykatat Themelore të Kosovës 2013 dhe 2014		Kolona 1: Lëndët   Kolona 2: Personat e përfshirë													
		Gjilan		Prizren		Pejë		Prishtinë		Ferizaj		Gjakovë		Mitrovicë	
2013	Të mbetura nga viti 2012	0	0	0	0	0	0	63	441	0	0	13	91	14	30
	Të reja, pranuar gjatë 2013	13	18	25	124	3	9	63	442	3	5	12	56	0	0
	<b>Total gjatë vitit 2013</b>	<b>13</b>	<b>18</b>	<b>25</b>	<b>124</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>126</b>	<b>883</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>25</b>	<b>147</b>	<b>14</b>	<b>30</b>
	Të zgjidhura gjate vitit 2013	13	18	14	74	2	8	70	464	0	0	5	13	0	0
	<b>Të zgjidhura në vitin 2013 (%)</b>	<b>100%</b>		<b>56%</b>		<b>67%</b>		<b>56%</b>		<b>0%</b>		<b>20%</b>		<b>0%</b>	
2014	Të mbetura nga viti 2013	0	0	11	50	1	1	56	419	3	5	20	134	14	30
	Të reja, pranuar gjatë 2014	1	1	16	16	8	8	51	69	1	1	19	51	73	98
	<b>Total gjatë vitit 2014</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>27</b>	<b>66</b>	<b>9</b>	<b>9</b>	<b>107</b>	<b>488</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>39</b>	<b>185</b>	<b>87</b>	<b>128</b>
	Të zgjidhura gjate vitit 2014	0	0	24	63	8	8	12	20	1	2	27	124	2	12
	<b>Të zgjidhura në vitin 2014 (%)</b>	<b>0%</b>		<b>89%</b>		<b>89%</b>		<b>11%</b>		<b>25%</b>		<b>69%</b>		<b>2%</b>	
	Të mbetura për vitin 2015	n/a	1	3	3	1	1	95	468	3	4	12	61	85	116

---

## 4. Policia e Kosovës

Policia e Kosovës (PK) është kryesisht përgjegjëse për të mbajtur rendin dhe sigurinë në proceset zgjedhore, dhe është hallkë e rëndësishme në zinxhirin e drejtësisë në zgjedhje. Përveç mbajtjes së rendit gjatë fushatave zgjedhore dhe ditës së zgjedhje, PK gjithashtu ka rol në hetimet e lëndëve të PSH dhe PZAP si dhe në ekzekutimin e vendimeve të gjykatave.

D4D ka pranuar të dhëna nga PK për fushatat dhe ditën e zgjedhjeve gjatë zgjedhjeve lokale 2013 dhe të përgjithshme 2014 (Figura 14). Gjatë fushatës në zgjedhjet e vitit 2013, PK ka hapur 37 lëndë të shkeljeve zgjedhore. Nuk ka detaje mbi llojin apo natyrën e shkeljeve, por kjo mund të përfshijë raste kur polica ka qenë dëshimtar i shkeljeve gjatë ngjarjeve politike, dhe ka shoqëruar personat e përfshirë në PK për marrje në pyetje. Më shumë se një e treta (41%) e lëndëve janë referuar në PSH për hetime të mëtejshme. Në zgjedhjet e vitit 2014, ka pasur shumë më pak lëndë të hapura.

*Figura 14: Përmbledhje e lëndëve të PK dhe personave të arrestuar, gjatë zgjedhjeve 2013 dhe 2014*

Policia e Kosovës	2013	2014
Fushata Zgjedhore	37 lëndë, prej të cilave 15 referuar në PSH	4 lëndë të referuara në PSH
Dita e Zgjedhjeve	47 lëndë në hetime me PSH	25 lëndë të hetuara me PSH
	37 persona të arrestuar	18 persona të arrestuar

Një numër të konsiderueshëm i lëndëve inshte iniciuar nga policia për shkelje në ditën e zgjedhjeve. Në zgjedhjet e vitit 2013, 37 persona janë arrestuar në ditën e zgjedhjeve. Edhe pse ky numër është përgjysmuar në 2014, numri personave që arrestohen në ditën e zgjedhjeve vazhdon të jetë shqetësim i madh. Si pjesë e zinxhirit institucional për drejtësi në zgjedhje, PK duhet që të vazhdoj reagimet e menjëhershme nëse ka dëshmi se është bërë shkelje e procesit zgjedhor, dhe të ndihmojë institucionet e tjera për të përfunduar hetimet.

---

Puna pro-aktive e PK gjatë zgjedhjeve lokale 2013 siç duket ka qenë masë parandaluese për shkelje në zgjedhje e vitit 2014, pasi që numri i lëndëve dhe personave të arrestuar ka qenë shumë më i ulët.

---

## 5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Nëse Prokuroria Shtetëtare posedon dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e veprës penale që ndërlidhet me zgjedhjet, atëherë kundër personave të përfshirë ngritet aktakuzë në gjykatën kompetente. Të gjitha lëndët trajtohen në Gjykatat Themelore, ku gjyqtarët nxjerrin aktgjykime për çdo lëndë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka ofruar të dhëna vetëm për vitin 2014, andaj krahasimi me të dhënat e vitit 2013 apo vitet e mëparshme është i pamundur. Gjatë vitit 2014, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka trajtuar 281 lëndë të ndërlidhura me zgjedhjet, nga të cilat dy të tretat kanë qenë të trashëguara nga vitet paraprake. Viti 2014 ka qenë i suksesshëm për gjykatat, duke marrë parasysh faktin që numri i lëndëve të zgjidhura (128), ka qenë më i madh se sa numri i lëndëve të pranuar gjatë vitit të njëjtë (93). Kjo tregon një shkallë të lartë të efikasitetit në trajtimin dhe priorizimin e lëndëve të zgjedhjeve si dhe zvogëlimin e lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake. Megjithatë, ende kanë mbetur edhe 153 lëndë për vitin 2015, ku janë të përfshirë 536 persona (që shënon rënie me krahasim me 188 lëndë dhe 934 persona të përfshirë) (Figura 15).

*Figura 15: Pasqyra vjetore e lëndëve dhe personave të përfshirë, për vitin 2014*

Pasqyra vjetore - 2014	Lëndët	Personat
Lëndët e mbetura nga vitet paraprake	188	934
Lëndët e reja të pranuar gjatë vitit 2014	93	238
<b>Total gjatë vitit 2014</b>	<b>281</b>	<b>1.172</b>
Të zgjidhura gjatë vitit 2014	128	636
Lëndët e mbetura	153	536

Pothuajse nëntë nga dhjetë lëndët e zgjedhjeve ka pasur të bëjë me veprën penale “Keqpërdorimi i të drejtës së votimit”, që mbulon situatat kur personat kryejnë një apo më shumë nga

shkeljet në vijim: a) voton apo tenton të votojë në emër të personit tjerër; b) voton apo tenton të votojë edhe pasi ka votuar një herë; dhe c) shfrytëzon më shumë se një listë votimi (Neni 216 i Kodit Penal). Lëndët tjera kanë të bëjnë me keqpërdorimin e pozitës zyrtare gjatë zgjedhjeve (3,6%), pengimin e procesit të votimit (3,6%), cënimi i përcaktimit të lirë të votuesve (2,5%), dhënia ose marrja e rryshfetit në lidhje me votimin (1,4%) apo shkelje të tjera (1,5%). Numri i personave të përfshirë është zakonisht katër herë më i madh se numri i lëndëve, e që është pasojë e ndjekjes penale kolektive për anëtarët e këshillave të vendvotimeve (Figura 16).

*Figura 16: Numri i lëndëve dhe personave të përfshirë, sipas natyrës së shkeljeve*

Veprat penale	Lëndët	Personat
Cënimi i së drejtës për të kandiduar (Neni 210)	0	0
Kanosja e kandidatit (Neni 211)	0	0
Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar (Neni 212)	1	2
Cënimi i përcaktimit të lirë të votuesve (Neni 213)	7	9
Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve (Neni 214)	10	46
Dhënia ose marrja e rryshfetit në lidhje me votimin (Neni 215)	4	5
Keqpërdorimi i të drejtës së votimit (Neni 216)	246	1.093
Pengimi i procesit të votimit (Neni 217)	10	14
Cënimi i fshehtësisë së votimit (Neni 218)	3	3
Falsifikimi i rezultateve të votimit (Neni 219)	0	0
Asgjësimi i dokumenteve të votimit (Neni 220)	0	0
<b>TOTAL</b>	<b>281</b>	<b>1.172</b>

Nga 128 lëndët e zgjidhura gjatë vitit 2014, 101 (79%) prej tyre kanë rezultuar me aktgjykim fajësues. Në këto raste kanë qenë të përfshirë 636 persona, nga të cilët vetëm 10 janë dënuar me burg, ndërsa 5 të tjerë janë dënuar me gjoja (Figura 17).

Në nëntë nga dhjetë raste, gjykata ka shqiptuar dënime me



kusht. Ky lloj i vendimit duhet analizuar me kujdes, dhe duhet parë nëse ky lloj i dënimit është proporcional me pasojat e shkeljeve dhe veprave penale që janë kryer. Dënimi me kusht zakonisht nënkupton burgim dhe/apo gjobitje, por kryesi i veprës nuk e vuan dënimin nëse ai apo ajo respekton kushtin specifik të përcaktuar nga gjykata. Një nga kushtet mund të jetë që kryesi i veprës penale të mos kryej ndonjë vepër tjetër për një periudhë të caktuar kohore.

Në anën tjetër për një të pestën e lëndëve gjykata ka vendosur të mos i procedoj për shkak të arsyeve të ndryshme procedurale, ndërsa një numër i vogël të pandehurve janë shpallur të pafajshëm.

*Figura 17: Numri i lëndëve të zgjidhura dhe personave të përfshirë, sipas aktgjykimit dhe shkeljes (numri i personave në kllapa)*

Shkelja	Fajtor			Pafajshëm dhe tjerë		
	Burg	Gjohë	Me kusht	Pafajshëm	Refuzuar	Tjerë
Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve (Neni 213)	0	1 (1)	2 (2)	0	0	0
Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve (Neni 214)	0	0	0	1 (1)	2 (15)	0
Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin (Neni 215)	0	0	0	0	0	1 (2)
Keqpërdorimi i të drejtës së votimit (Neni 216)	5 (10)	2 (4)	89 (462)	2 (7)	21 (122)	0 (8)
Pengimi i procesit të votimit (Neni 217)	0	0	2 (2)	0	0	0
<b>TOTAL</b>	<b>5 (10)</b>	<b>3 (5)</b>	<b>93 (466)</b>	<b>3 (8)</b>	<b>23 (137)</b>	<b>1 (10)</b>

Deri në vitin 2012, kur u ndryshua Kodi Penal, keqpërdorimet dhe shkeljet e zgjedhjeve nuk janë konsideruar si vepra të rënda penale. Prandaj, lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet paraqesin risi për shumicën e gjyqtarëve, dhe aspektet

---

teknike dhe procedurale të zgjedhjeve e vështirësojnë punën e gjyqtarëve për zgjidhjen e lëndëve të kësaj natyre. Numri i madh i dënimeve me kusht lë të nënkuptohet që gjyqtarët janë relativisht tolerant ndaj veprave penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet, dhe se dënimi me burg për këto raste konsiderohet si shumë i ashpër nga ana e tyre. Shpallja e të pandehurve si fajtor me dënim me kusht, e humb kuptimin kur ata vazhdojnë rrugën për në shtëpitë e tyre me dënime shumë të buta. Gjithashtu, dënimet kolektive duket të jenë problematike për gjyqtarët ngase është vështirë të dëshmohet përgjegjësia e secilit individ të përfshirë, prandaj vijnë në shprehje dënimet me kusht.

---

## 6. Komisioni i Pavarur për Media

Si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e medieeve, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) luan rol të rëndësishëm për të siguruar që mediat audiovizuele operojnë në përputhje me kriteret e përcaktuara me legjislacionin për zgjedhjet.

Në katër palë zgjedhjet e fundit KMP ka trajtuar 225 ankesa kundër mediave audiovizuele. Transmetuesit janë të obliguar të mbajnë regjistra në baza ditore dhe orarin e kohës së transmetimit me dhe pa pagesë për secilin subjekt politik. Tri të katërtat e ankesave të proceduara kanë pasur të bëjnë me dështimin e medieeve për të dorëzuar ditarët në KPM. Ankesat tjera kanë pasur të bëjnë me dështimin për të ndarë kohën pa pagesë të transmetimit (6%), shkeljen e heshtjes zgjedhore (6%), praninë e fëmijëve në reklammat politike, dhe shkelje të tjera (Figura 18).

*Figura 18: Numri i ankesave në KPM kundër mediave audiovizuele, sipas natyrës së ankesës, në zgjedhjet 2009 deri 2014*

Natyra e ankesës	2009	2010	2013	2014
Dështimi për të dorëzuar ditarët në KPM	35	0	58	75
Dështimi për kohë transmetuese pa pagesë	3	1	10	0
Shkelja e heshtjes zgjedhore	7	1	3	2
Mos-identifikimi i përgjegjësit për spotit	0	0	0	6
Prania e fëmijëve në spote	0	0	6	0
Transmetimi jashtë periudhës së fushatës	0	0	0	5
Pronarët e mediave kanë garuar në zgjedhje	0	0	4	1
Transmetimi i spoteve gjatë lajmeve	2	0	0	0
Tjera	2	1	3	0
<b>TOTAL</b>	<b>49</b>	<b>3</b>	<b>84</b>	<b>89</b>

Rritja e numrit të ankesave në zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014 tregon për një aktivitet të shtuar të KPM, subjekteve politike dhe kandidatëve për të iniciuar ankesa për shkelje nga ana e medieeve. Numri i ankesave ka arritur kulminacionin në periudhën 2013-2014, gjë që tregon se trendet pozitive në

zgjedhje nuk gjejnë aplikim edhe në rastin e medieeve. Pjesa dërmuese e ankesave, apo 92% janë iniciuar *ex-officio* nga KPM. Me përjashtim të disa ankesave të iniciuara nga LDK dhe AAK, partitë politike nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën për të parashtruar ankesa në KPM (Figura 19).

*Figura 19: Numri i ankesave sipas subjekteve parashtruese, në zgjedhjet prej 2009 deri 2014*

Entiteti	2009	2010	2013	2014
KPM	42	1	76	89
AAK	1	0	1	0
AKR	0	0	1	0
AKR/LDD	1	0	0	0
LDK	1	1	0	0
VAKAT	1	0	0	0
Tjera	3	1	6	0
<b>TOTAL</b>	<b>49</b>	<b>3</b>	<b>84</b>	<b>89</b>

Shumica e ankesave të dorëzuara kanë qenë kundër radioeve lokale (62%) dhe televizioneve lokale (24%). Gjithashtu, ka pasur disa ankesave ndaj shtëpive mediale (Figura 20).

*Figura 20: Numri i shkeljeve të pretenduara nga agjencitë mediale, në zgjedhjet prej 2009 deri 2014*

Media	2009	2010	2013	2014
Radio Televizioni i Kosovës (RTK)	1	0	4	2
Radio Televizioni 21 (RTV21)	1	0	2	1
Kohavision (KTV)	1	0	3	1
Klan Kosova	2	2	5	2
Rrokum TV	1	0	0	2
Televizionet lokale	12	1	16	26
Radiot lokale	31	0	54	55
<b>TOTAL</b>	<b>49</b>	<b>3</b>	<b>84</b>	<b>89</b>

Për të gjitha ankesat kundër medieeve, në zgjedhjet e përiudhës 2009-2014, Komisioni i Pavarur i Mediave ka

---

lëshuar letër vërejtje për agjencitë mediale, duke kërkuar prej tyre respektimin e kriterëve të përcaktuara me ligjin për zgjedhjet. Në të gjitha rastet mediat kanë adresuar rekomandimet e KPM.

Përderisa subjektet politike vazhdimisht pretendojnë se agjencitë e medieve janë të afërta apo anojnë nga subjektet e caktuara politike, numri i ankesave të dorëzuara në KPM duket relativisht i vogël. Subjektet politike mund të nënvlerësojnë rolin e KPM në raport me mediat, apo mund të mos jenë të njoftuara për mundësitë dhe procedurat për ankesat.

---

## Udhëzues për bashkëpunim institucional

Gjatë vitit 2014, D4D ka organizuar disa punëtori, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal, me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve, autoriteteve gjyqësore si dhe organizatave vendore e ndërkombëtare për të diskutuar për mësimet e mësuara nga zgjedhjet e kaluara. Gjatë diskutimeve rreth këtyre mësimëve, për të gjithë pjesëmarrësit ishte e qartë që koordinimi në mes të PZAP, KQZ, PSH, KGJK dhe PK ka qenë faktor kyç për të siguruar zgjedhje të lira dhe të drejta në vitin 2013 dhe 2014. Zgjidhja e kontesteve zgjedhore është proces i ndërvarur, dhe se koordinimi në mes të këtyre institucioneve duhet të forcohet dhe sigurohet me ligj në baza të përhershme.

Para se të nënshkruanin memorandumet e mirëkuptimit në vitin 2013, institucionet u konsultuan edhe me D4D si një nga organizatat e shoqërisë civile që angazhohet në fushën e zgjedhjeve dhe morën parasysh kontributin e ofruar. D4D rekomandoi që pesë institucionet (KQZ, PZAP, PSH, KGJK dhe PK) të nënshkruajnë një memorandum të ritë mirëkuptimit përmes të cilit do të rregullohej koordinimi i përhershëm. Përveç kësaj, këto institucione duhet të shqyrtojnë mundësinë e krijimit të një organi të përbashkët i cili do të koordinonte dhe mbikëqyrte bashkëpunimin në baza të rregullta. Për të qenë edhe më ambicioz, memorandum i bashkëpunimit mund të pasqyrohet edhe në aktet nën-ligjore dhe të bëhet i obligueshëm në aspektin ligjor, dhe të mos mbetet çështjet e vullnetit të mirë të udhëheqësve të institucioneve.

Si vazhdimësi të punës për drejtësinë në zgjedhje, D4D ka përgatitur edhe një listë me veprimet e sugjeruara për secilin institucion në secilën fazë të ciklit zgjedhor, me qëllim që të forcohet zinxhiri institucional. Në kuadër të kësaj liste përfshihet kontributi i shumë akterëve të cilët janë konsultuar përgjatë procesit, duke përfshirë përfaqësues të

---

institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve, gjyqtarë, prokurorë, zyrtar të policisë dhe ekspertë të shoqërisë civile. Në vijim prezantohen veprimet e propozuara për secilin institucion, dhe për secilën fazë të ciklit zgjedhor: a) Periudha parazgjedhore, b) Periudha zgjedhore dhe c) Periudha paszgjedhore

Kjo listë është përgatitur në formatin që u lejon lexuesve të shohin se çfarë bëjnë këto institucione në secilën fazë të ciklit zgjedhor, dhe mund ta gjeni edhe si shtojcë të këtij raporti në formë elektronike.

---

## 1. PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHITRESA

### Periudha para-zgjedhore (para shpalljes së zgjedhjeve)

- Zhvillimi i planit operativ për zgjedhje;
- Mirëmbajtja e databazës së personave të dënuar të cilëve iu është ndaluar pjesëmarrja në zgjedhje (si kandidat, staf administrativ);
- Informimi i KQZ-së për listën e personave të dënuar, dhe subjektet politike të cilat nuk i kanë paguar obligimet financiare të gjobave;
- Shqyrtimi i mënyrave për lehtësimin e dorëzimit të ankesave;
- Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me organizata vëzhguese.

### Periudha zgjedhore (shpallja e zgjedhjeve deri te certifikimi i rezultateve)

- Informimi i subjekteve politike, vëzhguesve, dhe votuesve për procedurat e ankesave;
- Aplikimi i dënimeve dhe gjobave efikase kundër entiteteve që kanë kryer shkelje;
- Informimi i vazhdueshëm i publikut për vendimet e PZAP-së, për çdo lëndë;
- Sigurimi që autoritetet e tjera i ndjekin rastet të cilat PZAP i referon tek ata;
- Udhëzimi i KQZ-së mbi kodet e qendrave dhe vendvotimet për të cilat duhet ruajtur materialet zgjedhore.

### Periudha pas-zgjedhore (pas certifikimit të rezultateve)

- Ndjekja e lëndëve të cilat referohen nga PZAP-i për në PSH, dhe ofrimi i informatave sipas nevojës;
- Kontributi në reformën zgjedhore, dhe shqyrtimi i rregulloreve të brendshme dhe procedurave;
- Shqyrtimi i lëndëve që kanë të bëjnë me raportimin e financave vjetore apo të fushatës;
- Ngritja e kapaciteteve të Sekretariatit të PZAP-së, për drejtësi në zgjedhje;
- Zhvillimi i strategjive për informimin e publikut dhe transparencë.



---

## 2. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

### Periudha para-zgjedhore (para shpalljes së zgjedhjeve)

- Mirëmbajtja e databazës së personave të cilët kanë bërë shkelje në zgjedhjet e kaluara
- Ofrimi i programeve orientuese dhe trajnimeve për prokurorët, policinë, gjykatësit dhe sekretariatit e këtyre institucioneve;
- Përgatitja dhe shpërndarja e udhëzuesve për prokurorët dhe gjykatësit, që përfshijnë informata për të gjitha fushat e zgjedhjeve (procedurat e votimit, siguria, financimi politik), dhe çështje më specifike siç janë auditimi dhe hetimi i rezultateve;
- Informimi i vazhdueshëm i publikut mbi dënimet të cilat janë shqiptuar nga autoritetet e gjyqësorit ndaj personave të cilët kanë bërë shkelje.

### Periudha zgjedhore (shpallja e zgjedhjeve deri te certifikimi i rezultateve)

- Sigurimi që personat të cilët kanë kryer vepra penale dhe kanë bërë shkelje zgjedhore të mos përfshihen në administrimin e zgjedhjeve;
- Informimi i anëtarëve të komisioneve zgjedhore, dhe stafit teknik dhe votuesve për dënimet e aplikueshme me Kodin Penal;
- Shqyrtimi i mundësisë së bashkëpunimit në mes të ekipit të hetimit dhe auditimit në Qendrën e Rezultateve, dhe autoriteteve të gjyqësorit;
- Sigurimi që subjektet politike I kanë paguar gjobot dhe obligimet e tyre ligjore para certifikimit për zgjedhje.

### Periudha pas-zgjedhore (pas certifikimit të rezultateve)

- Ruajtja e materialeve (kutive të votimit, FPR, FRK) bazuar në udhëzimet e PZAP-së dhe PSH-së;
- Ofrimi i provave dhe dëshmimeve tek prokurorët dhe policia, sipas nevojave;
- Shpërndarja e zyrtarëve komunal zgjedhor në seanca gjyqësore, në të gjitha komunat e Kosovës;
- Rritja e besueshmërisë së publikut në trupat menaxhues zgjedhor dhe autoritetet e gjyqësorit;
- Ndjekja e vazhdueshme e çdo lënde në procedurë gjyqësore, dhe mbledhja e të dhënave e raporteve;
- Kontributi në reformën zgjedhore, dhe shqyrtimi i rregullave të brendshme dhe procedurave.

---

### 3. PROKURORIA SHETËTORE

#### Periudha para-zgjedhore (para shpalljes së zgjedhjeve)

- Sigurimi për KQZ-në i databazës së fundit të personave të cilët janë nën hetime apo kanë aktakuzë për vepra penale zgjedhore;
- Ofrimi i trajnimeve për prokurorët në nivel qendror dhe lokal mbi zgjedhjet dhe veprat penale zgjedhore;
- Zhvillimi i planit operacional për shpërndarjen e prokurorëve në të gjitha komunat gjatë periudhës zgjedhore;
- Zhvillimi i planit operacional, alokimi i resurseve dhe buxhetit për ndjekjen e lëndëve të mbetura nga zgjedhjet e kaluara;
- Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me organizata vëzhguese;
- Pjesëmarrja në programin orientues të KQZ-se.

#### Periudha zgjedhore (shpallja e zgjedhjeve deri te certifikimi i rezultateve)

- Monitorimi i ambientit para zgjedhorë, aktiviteteve të fushatës dhe fushatën politike;
- Vendosja e të paktën dy prokurorëve në të gjitha komunat e Kosovës gjatë ditës së zgjedhjeve;
- Koordinimi i operacioneve me KQZ-në në ditën e zgjedhjeve;
- Veprimi i menjëhershëm dhe i saktë në rast se dikush kryen vepra penale zgjedhore.

#### Periudha pas-zgjedhore (pas certifikimit të rezultateve)

- Përndjekja e vazhdueshme e personave të dyshuar dhe ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë;
- Kërkimi i ndihmës dhe informatave nga trupat menaxhues të zgjedhjeve, sipas nevojës;
- Udhëzimi i KQZ-së mbi qendrat dhe vendotimet për të cilat duhet ruajtur materialet zgjedhore;
- Koordinimi me organizatat vëzhguese, nëse kanë dëshmitarë apo prova;
- Kontributi në reformën zgjedhore, dhe shqyrtimi i rregullave të brendshme dhe procedurave.

---

#### 4. POLICIA E KOSOVËS

##### **Periudha para-zgjedhore (para shpalljes së zgjedhjeve)**

- Koordinimi i përgatitjeve për zgjedhje me trupat menaxhues zgjedhor dhe autoritetet e gjyqësorit;
- Zhvillimi i planit operacional dhe I sigurisë së zgjedhjeve, për shpërndarjen e policisë gjatë periudhës zgjedhore, në bashkëpunim me KQZ;
- Ofrimi i trajnimeve për zyrtarët policorë mbi shkeljet në zgjedhje, në bashkëpunim me KQZ dhe PZAP;
- Mbledhja e statistikave dhe raporteve të ndryshme;
- Vlerësimi i rrezikut të qendrave të votimit, QNR, depos.

##### **Periudha zgjedhore (shpallja e zgjedhjeve deri të certifikimi i rezultateve)**

- Shpërndarja e zyrtarëve policorë dhe ofrimi e sigurisë gjatë aktiviteteve të fushatës zgjedhore, sipas nevojës;
- Veprimi i menjëhershëm dhe i saktë bazuar në udhëzimet nga PSH dhe PZAP;
- Shpërndarja e policëve në të gjitha qendrat e votimit të Kosovës në ditën e zgjedhjeve, dhe koordinimi me KQZ-në;
- Vazhdimi i bashkëpunimit me KQZ-në në dhomën e operacioneve në ditën e zgjedhjeve;
- Bashkëpunimi me Prokurorinë në lidhje me incidentet e mundshme.

##### **Periudha pas-zgjedhore (pas certifikimit të rezultateve)**

- Bërja e hetimeve të thella për çdo lëndë, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Prokuroria ose organet e drejtësisë;
- Te bëjnë hetime individuale për secilin person të përfshirë në rast;
- Veprimi i menjëhershëm sipas udhëzimeve të PSH dhe gjykatave.

---

## 5. KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

### Periudha para-zgjedhore (para shpalljes së zgjedhjeve)

- Sigurimi me kohë për organet kompetente i databazës së fundit të personave të cilët kanë kryer apo janë nën hetime për vepra penale të zgjedhjeve;
- Ofrimi i trajnimeve për gjykatësit dhe stafin e gjykatave të cilët merren me lëndët e zgjedhjeve;
- Vazhdimi i gjykimeve të lëndëve nga zgjedhjet e kaluara;
- Aplikimi i dënimeve proporcionale ndaj kryerësve të veprave penale;
- Publikimi i vendimeve të gjykatave, vendosja e tyre në ueb me kohë;
- Informimi i vazhdueshëm i publikut mbi masat të cilat janë shqiptuar nga autoritetet e gjyqësorit ndaj personave të cilët kanë bërë shkelje.

### Periudha zgjedhore (shpallja e zgjedhjeve deri te certifikimi i rezultateve)

- Koordinimi me Prokurorinë e Shtetit dhe PZAP-në në lëndët e mundshme mbi veprat penale zgjedhore;
- Veprimi i menjëhershëm dhe fillimi i procedurave për gjykimin e lëndëve të zgjedhjeve;
- Prioritizimi dhe gjykimi i lëndëve të cilat mund të ndikojnë në rezultatet përfundimtare;
- Informimi i publikut për vendimet e gjykatave për lëndët e zgjedhjeve, dhe publikimi i vendimeve në ueb;
- Sigurimi që publiku të ketë qasje në informata që duhet të jenë transparente, pa i shkelur të drejtat për të dhënat personale.

### Periudha pas-zgjedhore (pas certifikimit të rezultateve)

- Vendosja dhe përfundimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me zgjedhje, dhe përfundimi i këtyre lëndëve para se të ndodhin zgjedhje të reja;
- Aplikimi i dënimeve proporcionale ndaj personave që kanë bërë krimet;
- Informimi i publikut për vendimet e gjykatave për lëndët e zgjedhjeve, dhe publikimi i vendimeve në ueb;
- Kontributi në reformën zgjedhore, dhe shqyrtimi i rregullave të brendshme dhe procedurave;
- Të sigurohet që personat e dënuar ti vuajnë dënimet e gjykatave;
- Te ftoj zyrtarët komunal zgjedhor në seancat gjyqësore që kanë të bëjnë me zgjedhje.

---

## Lista e Publikimeve

### Zgjedhjet & Partitë Politike:

- #1 Instituti D4D. Shtator 2011. Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010
- #2 Instituti D4D. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si të rikthejmë besimin në zgjedhje?
- #3 Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën
- #4 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?
- #5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit – Përceptimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.
- #6 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Deforma zgjedhore – Dy vite pas, reforma në pikën zero
- #7 Leon Malazogu dhe Brenna Gautam. Me kontribut nga Rezarta Delibashzade dhe Ngadhujim Halilaj. 26 nëntor 2014. Busolla ideologjike e Kosovës – Hartë e orientimit të partive politike
- #8 Dardan Berisha. Me kontribut nga Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu dhe Rina Vokshi. Korrik 2015. Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje

### Marrëdhëniet ndëretnike:

- #1 Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorić. Nëntor 2011. Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak. PER-K/D4D Institute and NPC-Belgrade
- #2 & #3 Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/D4D.
- #4 Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen. PER-K/Instituti D4D
- #5 Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/Instituti D4D

---

## **Interesi Publik:**

#1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. 'Taksa' e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?

#2 Gashi, Drilon and Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë

#3 Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik

#4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë

#5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Ēallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati?

## **Memorandume Reaguese:**

#1 Instituti D4D. Nëntor 2012. Memorandumi reagues Nr. 1 – Reagimi i tepruar i policisë

#2 Instituti D4D. Dhjetor 2012. Memorandumi reagues Nr. 2 – Modeli i dy Gjermanive

#3 Instituti D4D. 12 Korrik 2013. Memorandumi reagues Nr. 3 – Kriteria të qarta për komuna të reja

#4 Instituti D4D & Qëndrim Gashi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 4 – Universiteti i Prishtinës në rreth vicioz

#5 Instituti D4D dhe Kushtrim Palushi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 5 – Reforma zgjedhore

## **Rekomandimet e forumit reforma:**

#1 Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Struktura e KQZ-së

#2 Hartuar nga Instituti D4D. 17 janar 2011. Sistemi zgjedhor

#3 Hartuar nga Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Riparimi i listës së votuesve

#4 Hartuar nga Instituti D4D. 12 dhjetor 2011. Rekomandime për Zgjedhjen e Drejtëpërdrejtë të Presidentit të Kosovës

#5 Mbështetur nga: D4D, KIPRED, INPO, KMDLNJ, INDEP, DT, KHK, QPA, dhe NOMP. Për reformë të mirëfilltë zgjedhore

#6 Instituti D4D. 20 Dhjetor 2011. Prezentimi i sistemit të zgjedhjeve

---

## **Indikatorët & skenarët:**

#1 Instituti D4D. Nëntor 2010. Para dhe Pas-Performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010

#2 Instituti D4D. Shteti në Pasqyrë: Indikatorët e Bazuar në Performancë

#3 Malazogu, Leon. Nëntor 2013. As për emër nuk janë pajtuar: Shtyrja e problemit nuk do të afrojë palët në lidhje me asociacionin/bashkësinë

#4 Malazogu, Leon. Janar 2014. Parashikime dhe skenare: Kosova dhe Bota në 2014

## **Publikime të tjera:**

#1 Seritë e editorialeve dhe rekomandimeve mund gjithashtu të gjinden në ueb-faqen tone.

---

Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

34: 324(496.51)(047)

Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje : shqyrtimi i lëndëve,  
dhe udhëzimi për bashkëpunim institucional / punimi i  
përgatitur nga Dardan Berisha. – Prishtinë : Demokraci për  
zhvillim, 2015. – 47 f. : ilustr. ; 21 cm.

1. Berisha, Dardan

**ISBN 978-9951-608-35-0**



Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) u themelua në prill të vitit 2010 nga një grup analistësh që shqëtësoheshin se ushtrimi i shtet-ndërtimit kishte lënë mënjanë demokracinë.

Visioni i D4D-së është të promovojë një shoqëri aktive dhe të arsimuar e cila merr pjesë në hapësirën publike dhe e përdor atë për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e burimeve të cilat janë efiçiente, të shpejta, afat-gjate dhe që sjellin zhvillim të paanshëm.

D4D ka ndikim në politika specifike, promovon qasjen ndërsektorale në zgjidhjen e problemeve, dhe trajton rutinën institucionale të vendim-marrjes duke rekomanduar përmirësime të vazhdueshme. Gjithashtu, D4D vepron me efikasitet që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutem vizitoni uebfaqen tonë: [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org).

Ky publikim është përkrahur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

ISBN 978-9951-608-35-0



9 789951 608350